



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

# Anketa e Kreditimit Bankar

Numër 14

M A R S 2 0 2 3

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

# **Anketa e Kreditimit Bankar dhe Pritjeve për Inflacionin**

Numër 14

**BOTUES**

© Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Departamenti i Analizave Ekonomike  
dhe i Stabilitetit Financiar

33 Garibaldi, Prishtinë 10000

Tel: ++383 38 222 055

Fax: ++383 38 243 763

**Faqja e internetit**

[www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)

**Adresa elektronike**

[economic.analysis@bqk-kos.org](mailto:economic.analysis@bqk-kos.org)

## Përmbajtja

<b>Anketa e Kreditimit Bankar</b> .....	4
Hyrje .....	4
Përmbledhja e rezultateve .....	4
Kutia 1. Metodologjia .....	7
Zhvillimet në standardet kreditore, në kushtet dhe rregullat kreditore, si dhe në kërkesën për kredi.....	8
Kreditë ndaj ndërmarrjeve .....	8
Standardet kreditore .....	8
Kushtet dhe rregullat.....	9
Kërkesa për kredi.....	9
Kreditë ndaj ekonomive familjare .....	10
Standardet kreditore .....	10
Kushtet dhe rregullat.....	11
Kërkesa për kredi.....	12
Financimi .....	13
Rezultatet e pyetjeve të fokusuara .....	14
<b>Pritjet për Inflacionin</b> .....	15
Metodologjia .....	15
Përmbledhja e rezultateve .....	16

## Anketa e Kreditimit Bankar

### Hyrje<sup>1</sup>

Me qëllim të rritjes së kapaciteteve analitike për një vlerësim sa më të mirë të dinamikave të kreditimit në Kosovë dhe pritjeve për zhvillimet në nivelin e çmimeve, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka dizajnuar dhe realizuar një anketë me bankat komerciale që operojnë në tregun bankar në Kosovë. Raporti që do të analizoj rezultatet e këtij anketimi, do të publikohet në frekuencë tremujore në web-faqen e BQK-së, me qëllim që të ofrojë një pasqyrë më të gjerë rreth perceptimit të rrezikut të bankave dhe gatishmërinë e bankave për të dhënë hua, si dhe, sjelljes së ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve kundrejt dinamikave në kreditim, si pasojë. Ky raport evidenton sjelljen kreditore për periudhën e tremujorit të katërt të vitit 2022, dhe pritjet e bankave për dinamikat në kreditim për tremujorin e parë të vitit 2023.

Përveç pyetjeve standarde, kjo anketë është plotësuar me tre pyetje shtesë në përpjekje për të adresuar ndikimin e presioneve inflacioniste në sjelljen e klientëve, rrjedhimisht reflektimin në rritje të rreziqeve dhe pritjet për materializimin e rrezikut kreditor. Në një nga pyetjet, bankat elaboruan mbi ndikimin indirekt të inflacionit në kostot e financimit të sektorit bankar. Gjithashtu, një nga pyetjet zbërthen ofertën dhe kërkesën kreditore sipas sektorëve ekonomik.

### Përmbledhja e rezultateve<sup>2</sup>

Shkalla e lartë e inflacionit që karakterizoi ekonominë e Kosovës edhe përgjatë gjithë vitit 2022 ka ndikuar në dobësimin e fuqisë blerëse të agjentëve në treg – përkthyer në dobësimin e kërkesës së përgjithshme në vend. Këto dinamika u reflektuan edhe në sjelljen e bankave, përmes rishikimit të politikave kreditore kundrejt kërkesës për financim.

Rritja vjetore e stokut të gjithsej kredive vazhdoi me ritëm të përshpejtuar deri në tremujorin e katërt të vitit 2022. Sidoqoftë, kreditë e reja krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak shënuan rënie, ndërsa ishin të njëjta në krahasim me tremujorin paraprak. Kjo dinamikë reflekton qasje më të kujdesshme të konsumatorëve në ndërmarrjen e borxheve shtesë. Aktiviteti kreditor u ndikua në masë më të madhe nga kërkesa kreditore, pasi që oferta kreditore nuk kishte ndryshime të rëndësishme gjatë këtij tremujori. Ndërsa për dallim me tremujorin aktual, bankat për TM1 2023 presin që kërkesa për kredi të ketë rënie marginale, përderisa oferta kreditore të ketë kryesisht lëvizje marginale pozitive.

Sipas bankave, dinamika e kreditimit të ndërmarrjeve gjatë këtij tremujori u ndikua në masë më të madhe nga kërkesa e rritur kreditore nga NVM-të, përderisa oferta kreditore mbeti kryesisht e pandryshuar. Në kuadër të ofertës kreditore, bankat raportuan standarde kreditore të pandryshuara gjatë vlerësimit të aplikacioneve të ndërmarrjeve për kredi në tremujorin e katërt të vitit 2022 (tabela 1). Në kontekst të pritjeve për ngadalësim ekonomik, rreziqet e lidhura me perspektivën jo të mirë në tregjet globale patën kontributin negativ kryesor në standardet kreditore. Përderisa, faktorët që patën ndikim deri në një masë pozitiv në standardet kreditore ishin pozita e mirë e likuiditetit të sektorit, presionet e konkurrencës në mes të bankave, si dhe mbështetja nga FKGK. Gjithashtu, norma e aprovimit të kredive për ndërmarrjet rezultoi të mos ketë pësuar ndonjë ndryshim të rëndësishëm gjatë këtij tremujori për të dy segmentet e ndërmarrjeve. Për tremujorin e parë të vitit 2023, bankat

<sup>1</sup> Për informata më të detajuara rreth qëllimit dhe historikut të anketës së kreditimit bankar në BQK, shikoni publikimin "Anketa e Kreditimit Bankar dhe Pritjeve të Inflacionit" Nr. 1.

<sup>2</sup> Pyetësi dhe seria kohore e rezultateve të AKB-së janë në dispozicion në faqen e internetit të BQK-së, nën vegzën e Anketës së Kreditimit Bankar.

pritet të aplikojnë ndryshime marginale në standardet kreditore, kryesisht ndryshime pozitive për NVM-të dhe negative për ndërmarrjet e mëdha (grafik 1). Pozita e mirë e likuiditetit, mbështetja nga FKGK dhe presioni i konkurrencës janë faktorët që pritet të kontribuojnë pozitivisht standardet kreditore, ndërkohë që pasiguritë në perspektivën e tregut vendor dhe global pritet të kontribuojnë negativisht. Norma e aprovimit të kredive pritet të ketë rënie marginale gjatë tremujorit të ardhshëm, kryesisht për ndërmarrjet e mëdha.

Kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat me rastin e dhënies së kredive për ndërmarrjet kishin lëvizje marginale për të dy segmentet e ndërmarrjeve. Konkretisht, u aplikua lehtësim marginal për kërkesën për kolateral, si rezultat i mbështetjes së FKGK-së dhe presionit të konkurrencës. Në tremujorin e ardhshëm, bankat pritet të aplikojnë ndryshime në kushtet dhe rregullat kryesisht për NVM-të, duke rritur normën e interesit në kredi në njërin anë dhe duke lehtësuar kërkesën për kolateral në anën tjetër. Ndryshimet pozitive në kushtet dhe rregullat e kredive për ndërmarrjet pritet të nxiten nga mbështetja nga FKGK dhe presionet e konkurrencës, përderisa ndryshimet negative pritet të nxiten nga perspektiva jo e mirë në tregun global dhe vendor, si dhe pritet për përkeqësim të cilësisë së portfolios kreditore.

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2022, kishte rritje të kërkesës për kredi bankare nga ndërmarrjet, nivel dukshëm më i lartë në krahasim me tremujorin paraprak. Sidoqoftë, kërkesa për kredi nga ndërmarrjet rezultoi të jetë më e ulët në krahasim me pritjet e bankave për TM4 2022, të shprehura në anketën e kaluar (TM3 2022). Indeksi i gjeneruar për kërkesën për kredi nga NVM-të u ndikua nga përgjigjet e pesë bankave të cilat deklaruan rritje të kërkesës. Ndërsa, kërkesa për kredi nga ndërmarrjet e mëdha kishte rritje marginale. Kjo rritje e kërkesës, sipas deklaratave të bankave, u nxit kryesisht nga rritja e kërkesës për financimin e inventarëve dhe kapitalit punues. Indeksi i gjeneruar për pritjet e bankave mbi kërkesën kreditore gjatë tremujorit të ardhshëm, tregon lëvizje marginale. Ky rezultat u ndikua nga përgjigjet e pesë bankave, ku prej tyre dy banka presin rënie të kërkesës përderisa tre bankat tjera presin rritje deri në një masë të kërkesës për kredi. Njëkohësisht, bankat presin përkeqësim marginal të cilësisë së aplikacioneve të pranuar për kredi, sidomos nga NVM-të.

Stoku i kredive për ekonomitë familjare shënoi rritje të përshpejtuar vjetore në dhjetor 2022. Dinamikë kjo e mbështetur kryesisht nga kërkesa kreditore, pasi që oferta kreditore kishte ndryshime marginale. Standardet kreditore në tremujorin aktual, në përgjithësi, rezultojnë të jenë të përafërta me pritjet e bankave të shprehura në anketën e kaluar. Standardet kreditore u lehtësuan marginalisht për të dy llojet e kredive për ekonomitë familjare, e shprehur nga një bankë me rëndësi sistemike e cila u mbështet në uljen e rrezikut nga kolaterali i kërkuar, kryesisht si pasojë e marrëveshjeve me kompanitë ndërtimore. Në tremujorin e parë 2023, bankat nuk presin lëvizje të rëndësishme në standardet kreditore për të dy llojet e kredive për ekonomitë familjare (tabela 1).

Kushtet dhe rregullat për kreditë e reja për ekonomitë familjare përgjithësisht u shtrënguan deri në një masë. Rezultatet e gjeneruara kryesisht reflektojnë shtrëngime në një nivel të njëjtë për të dy llojet e kredive. Saktësisht, bankat aplikuan shtrëngime përmes rritjes së normës së interesit. Ndërsa, lehtësim marginal u aplikua në kërkesat për kolateral. Faktori kryesor në rritjen e normës së interesit ishte perspektiva jo e mirë e tregjeve globale, e që për pjesën më të madhe të bankave nënkupton rritjen e normës së EURIBOR-it, normë e aplikuar në kreditë më normë variabile të interesit. Për tremujorin e parë të vitit 2023, bankat në përgjithësi presin shtrëngime marginale në kushtet dhe rregullat për kredi të ekonomive familjare. Shtrëngimi i kushteve dhe rregullave pritet të jetë deri në një masë më i lartë për kreditë konsumuese. Kryesisht, kushtet dhe rregullat për të dy kategoritë pritet të shtrëngohen përmes rritjes së normës së interesit, edhe pse në nivel dukshëm më të ulët se sa vlerat për TM4 2022, dhe të lehtësohen në nivel të ulët kërkesat për kolateral. Gjithashtu, për kreditë konsumuese marginalisht pritet të shtrëngohen madhësia e maturiteti i kredive të aprovuara, përgjigje e deklaruar nga një bankë e vetme mirëpo me rëndësi sistemike.

Kërkesa për kredi nga ekonomitë familjare në përgjithësi ka shënuar rritje gjatë tremujorit të katërt 2022. E zbrërthyer sipas llojeve të kredive për ekonomitë familjare, rezulton që kërkesa për kredi shënoi rritje të përafërt për të dy llojet e kredive. Saktësisht, pesë banka, prej tyre tre me rëndësi sistemike, raportuan për rritje të kërkesës për të dy llojet e kredive. Nevoja për financim të konsumit dhe perspektiva e tregut të patundshmërive ishin faktorët që kontribuan pozitivisht, përderisa rënia e konfidencës së klientëve për kapacitetin e ripagimit të kredive ishte faktor që kontribuoi negativisht kërkesën kreditore. Në tremujorin e parë të vitit 2023, bankat nuk presin lëvizje të mëdha në kërkesën për kredi nga ekonomitë familjare. Bankat në përgjithësi presin lëvizje negative marginale të kërkesës për kredi, saktësisht këto lëvizje reflektojnë pritjet për rënie marginale të kërkesës për kreditë për blerjen e shtëpive (tabela 1). Rezultatet e anketës sugjerojnë se bankat presin që rënia e konfidencës së klientëve për kapacitetin e ripagimit të kredive të ndikojë deri në një masë rënien e kërkesës për kredi gjatë tremujorit të ardhshëm. Njëkohësisht, bankat presin përkeqësim, edhe pse në nivel të ulët, në cilësinë e aplikacioneve të pranuar për kredi, kryesisht për kreditë për blerjen e shtëpive.

**Tabela 1. Vlerësimi i bankave për ndryshimet në ofertën dhe kërkesën kreditore**

	Oferta (Standardet kreditore)		Kërkesa	
	TM4 2022	TM1 2023 (pritjet)	TM4 2022	TM1 2023 (pritjet)
<b>Ndërmarrjet</b>	➔	➔	⬆	➔
NVM	➔	➔	⬆	➔
Ndërmarrjet e mëdha	➔	➔	➔	➔
<b>Ekonomitë familjare</b>	➔	➔	➔	➔
Kredi për blerjen e shtëpive	➔	➔	➔	➔
Kredi konsumuese	➔	➔	⬆	➔

⬆ Lehtësim i standardeve kreditore/Rritje e kërkesës për kredi (indeks pozitiv mbi 0.20)  
 ➔ Lehtësim i standardeve kreditore/Rritje e kërkesës për kredi (indeks pozitiv nën 0.20)  
 ➔ Kryesisht pandryshime (indeks pozitiv/negativ deri 0.05)  
 ➔ Shtërim i standardeve kreditore/Rënie e kërkesës për kredi (indeks negativ nën 0.20)  
 ⬇ Shtërim i standardeve kreditore/Rënie e kërkesës për kredi (indeks negativ mbi 0.20)

Burimi: BQK.

Monitorimi prudent i performancës financiare të klientëve dhe vlerësimi më konservativ i aplikacioneve të reja për kredi nga bankat ndihmoi në përmirësimin apo mirëmbajtjen e performancës së ri-pagimit të kredive. Rrjedhimisht, bankat deklaruan përmirësim të cilësisë së portfolios kreditore, pasi që indeksi i përgjithshëm i përgjigjeve edhe këtë tremujor qëndroi negativ, edhe pse në nivel më të ulët në krahasim me tremujorin e kaluar. Ky përmirësim ishte më i lartë për segmentin e ekonomive familjare se sa për segmentin e ndërmarrjeve. Përderisa, për tremujorin e ardhshëm indeksi i gjeneruar pritet të ndërroj kahje dhe të kaloj në pozitiv, duke reflektuar pritjet e bankave për përkeqësim të cilësisë së portfolios kreditore. Këto pritje kryesisht u ndikuan nga dinamikat e rritjes së çmimeve në vend, e me të edhe nga rënia e fuqisë blerëse të klientëve. Më saktësisht, bankat presin përkeqësim të cilësisë së portfolios kreditore të ndërmarrjeve në nivel më të lartë se sa për ekonomive familjare. Gjashtë banka, ku katër prej tyre me rëndësi sistemike, presin rritje të kredive jo-performuese të ndërmarrjeve, kundrejt pesë bankave, gjithashtu katër prej tyre me rëndësi sistemike, të cilat presin të njëjtën për kreditë jo performuese të ekonomive familjare.

Bankat raportuan rritje të theksuar të qasjes në financim gjatë tremujorit të katërt të vitit 2022, duke tejkaluar nivelin e shënuar në tremujorin e kaluar (TM3 2022). Rezultati i agreguar i përgjigjeve të bankave u ndikua nga përgjigjet e tetë bankave të cilat deklaruan rritje të financimit, ku prej tyre dy banka me rëndësi sistematike deklaruan rritje të konsiderueshme të qasjes në financim. Depozitat e ekonomive familjare kishin rritjen më të madhe, pasuar nga depozitat e ndërmarrjeve. Financimi nga bankat amë nuk kontribuoi në rritje të financimit, ngase nuk rezultoi të ketë ndonjë lëvizje të rëndësishme. Ndërsa, financimi nga institucionet ndërkombëtare financiare shënoi rënie marginale. Sipas maturitetit, depozitat afatshkurtra ishin burimi i financimit me rritjen më të lartë gjatë këtij tremujori. Gjatë tremujorit të ardhshëm, në përgjithësi bankat presin rritje të qasjes në financim mirëpo në një nivel dukshëm më të ulët se sa ai i tremujorit aktual. Financimi përmes depozitave të ekonomive familjare pritet të prijë rritjen e financimit të sektorit bankar, pasuar nga financimi nga tregjet e parasë. Sa i përket maturitetit të financimit, bankat presin në këtë tremujor rritjen e financimit t'a dominojnë depozitat me maturitet afatgjatë. Dinamikë e nxitur nga ofertat e favorshme për tërheqjen e depozitave të afatizuara nga sektori bankar.

## Kutia 1. Metodologjia

### Pyetësi i Anketës së Kreditimit Bankar

Pyetësi i AKB është i bazuar në forma të standardizuara të pyetësorëve të përdorur nga Bankat Qendrore të vendeve të eurozonës dhe më gjerë. Megjithatë, pyetësi i BQK për AKB është modifikuar dhe përshtatur që në mënyrën më të mirë dhe më gjithëpërfshirëse të paraqet zhvillimet e kreditimit në sektorin bankar në Kosovë.

Pyetësi i AKB përbëhet nga 19 pyetje, të cilat mbulojnë ndryshimet në ofertën dhe kërkesën për kredi, faktorët që kontribuojnë në këto ndryshime si dhe qasjen në financim të sektorit bankar, në baza tre mujore. Pyetjet mbi kreditimin bankar fokusohen në dy kategori kryesore: (i) kreditë ndaj ndërmarrjeve, dhe (ii) kreditë ndaj ekonomive familjare. Për më tepër, kreditë ndaj ndërmarrjeve nën-kategorizohen në kreditë ndaj NVM-ve dhe kreditë ndaj ndërmarrjeve të mëdha, përderisa kreditë ndaj ekonomive familjare nën-kategorizohen në kreditë për blerjen e shtëpive dhe kreditë konsumuese. Për të gjitha kategoritë e lartpërmendura, ndryshimet në ofertën kreditore përcaktohen nga standardet kreditore të aplikuara gjatë aprovimit të kredive, kushtet dhe rregullat e aplikuara për kreditë e reja, norma e aprovimit të kredive, si dhe faktorët që ndikojnë në ndryshimet e tyre. Ndërsa, ndryshimet në kërkesën për kredi përcaktohen nga kërkesa për kredi (numri i aplikacioneve për kredi), cilësia e aplikacioneve të pranuar për kredi, si dhe faktorët që e ndikojnë kërkesën për kredi. Pyetjet e anketës kryesisht janë të formuluar për ndryshimet gjatë tre muajve paraprak dhe pritet për tre muajt e ardhshëm. Gjithashtu, pyetjet mbulojnë kreditë edhe në aspekt të maturimit të tyre dhe valutës në të cilën lëshohen.

Përveç pyetjeve standarde, pyetësi i AKB mund të përmbajë edhe pyetje shtesë mbi çështje specifike me interes për shpjegimin e zhvillimeve në sektorin bankar. Përderisa pyetjet standarde mbulojnë një periudhë tre-mujore, pyetjet shtesë mund t'i referohen ndryshimeve gjatë një periudhe kohore më të gjatë. Në anketim marrin pjesë dhjetë nga njëmbëdhjetë bankat që operojnë në Kosovë<sup>3</sup>. Rrjedhimisht, bankat pjesëmarrëse përfaqësojnë tregun e përgjithshëm bankar dhe sigurojnë një përfaqësim të duhur statistikor, duke marrë parasysh se përfaqësojnë rreth 98 përqind të aseteve të gjithsej sektorit bankar dhe 99.8 përqind të gjithsej kreditimit në sektorin bankar.

Pjesëmarrësve të anketës u kërkohet të tregojnë në mënyrë cilësore forcën e çdo shtrëngimi ose lehtësimi apo forcën e çdo ulje ose rritje, duke raportuar ndryshimet përmes pesë shkallëve si: (i) shtrënguar / ulur në mënyrë të konsiderueshme, (ii) shtrënguar / ulur në një masë, (iii) e pandryshuar, (iv) lehtësuar / rritur në një masë ose (v) lehtësuar / rritur në mënyrë të konsiderueshme.

### Gjenerimi i rezultateve të anketës së kreditimit bankar

Kuantifikimi i përgjigjeve të marra nga bankat individuale dhe agregimi i tyre për të paraqitur ndryshimet në nivel sektori arrihet përmes gjenerimit të një indeksi. Ky indeks gjenerohet për çdo kategori e nën-kategori të secilës pyetje, duke dhënë në këtë mënyrë një njësi kuantifikuese për përgjigjet e marra në nivel të sektorit.

<sup>3</sup> Banka e cila nuk është përfshirë në anketë është Komercialna Banka e cila ka aktivitet kreditor të limituar.



Fillimisht, përgjigjeve u përcaktohet një vlerë në bazë të forcës së ndryshimeve, konkretisht përgjigjeve ku bankat kanë deklaruar shtrëngim/ulje të konsiderueshme u përcaktohet vlera - 1, vlerë dyfish më e madhe se sa ajo e përcaktuar për përgjigjet kur bankat deklarojnë shtrëngim / ulje deri në një masë (vlerë prej -0.5). Ngjashëm, përgjigjet kur kemi lehtësim/rritje të konsiderueshme kanë vlerë 1, përderisa ato me lehtësim/rritje deri në një masë u përcaktohet vlera 0.5. Rezultatet po ashtu janë të peshuara në bazë të peshës që secila prej bankave ka në gjithsej kreditimin e sektorit bankar. Përfundimisht, pesha e secilës bankë sipas pjesëmarrjes në tregun e kredive shumëzohet me vlerën e përcaktuar në bazë të intensitetit të përgjigjes së dhënë, duke fituar indeksin në fjalë.

Më tutje, agregimi i indeksit në nivel sektori bëhet përmes shumës së indekseve të fituara për secilën bankë. Vlerat e indeksit janë në mes të -1 dhe 1, ku vlerat pozitive të indeksit paraqesin lehtësim, rritje apo kontribut pozitiv dhe në kontrast vlerat negative paraqesin shtrëngim, rënie apo kontribut negativ.


## Zhvillimet në standardet kreditore, në kushtet dhe rregullat kreditore, si dhe në kërkesën për kredi

### Kreditë ndaj ndërmarrjeve

#### Standardet kreditore

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2022, rezultati për standardet kreditore (udhëzimet e brendshme të bankave apo kriteret për aprovimin e kredive) të aplikuar për ndërmarrjet në përgjithësi nuk tregon lëvizje të rëndësishme. Përderisa, në anketën e kaluar (TM3 2022), bankat kishin deklaruar se presin standarde kreditore të lehtësuara edhe pse në nivel të ulët (grafiku 1).

Grafik 1. Ndryshimet në standardet kreditore të aplikuar për ndërmarrjet dhe faktorët që kontribuon



Në kuadër të kredive për ndërmarrjet, bankat deklaruan standarde kreditore të pandryshuara për të dy kategoritë. Kjo nënkupton që standardet kreditore të shtrënguara deri në një masë që bankat kishin deklaruar në anketën paraprake (TM3 2022) vazhdojnë të qëndrojnë. Faktori kryesor që ndikoi negativisht standardet kreditore ishte perspektiva jo e mirë në tregjet globale edhe pse rezultoi me një indeks negativ marginal prej 0.07. Përderisa, faktorët që deri në një masë ndikuan pozitivisht, duke i ofruar siguri sektorit bankar, ishin pozita e mirë e likuiditetit të sektorit, presionet e konkurrencës në mes të bankave, si dhe mbështetja nga FKGK.

Gjithashtu, norma e aprovimit të kredive për ndërmarrjet rezulton të mos ketë pësuar ndonjë ndryshim të rëndësishëm gjatë këtij tremujori për të dy segmentet e ndërmarrjeve.


Standardet kreditore në përgjithësi pritet të kenë ndryshime marginale në tremujorin e ardhshëm. Konkretisht, lehtësim pritet të kenë standardet kreditore për NVM-të, ndikuar nga pritjet e një banke

me rëndësi sistemike, ndërsa shtrëngim pritet për ndërmarrjet e mëdha, po ashtu ndikuar nga përgjigja e një banke me rëndësi sistemike. Pozita e mirë e likuiditetit, mbështetja nga FKGK dhe presioni i konkurrencës janë faktorët që pritet të kontribuojnë pozitivisht standardet kreditore. Përderisa, pasiguritë në perspektivën e tregjeve vendore dhe globale pritet të kontribuojnë negativisht të njëjtat. Norma e aprovimit të kredive pritet të ketë rënie marginale gjatë tremujorit të ardhshëm, kryesisht për ndërmarrjet e mëdha.

### Kushtet dhe rregullat

Në tremujorin e katërt të 2022, në përgjithësi, kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat me rastin e dhënies së kredive për ndërmarrjet (kushtet dhe rregullat përkatëse të një kontrate të caktuar për kredi) kishin lëvizje marginale për të dy kategoritë e ndërmarrjeve (grafiku 2). Konkretisht, për të dy kategoritë e ndërmarrjeve lehtësim marginal u aplikua për kërkesën për kolateral me indeks pozitiv prej 0.06. Ky rezultat u ndikua nga përgjigja e një banke të vetme, mirëpo me peshë të lartë dhe rëndësi sistemike, si rezultat i mbështetjes së FKGK-së. Presioni i konkurrencës në mes të bankave po ashtu ndikoi pozitivisht kushtet dhe rregullat e aplikuara.

Grafik 2. Ndryshimet në kushtet dhe rregullat e aplikuara për ndërmarrjet



Gjatë tremujorit të ardhshëm, kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat pritet të kenë lëvizje marginale. Në këtë kontekst, këto ndryshime kryesisht pritet të aplikohen për NVM-të. Saktësisht, në një anë pritet rritje e normës së interesit për kredi, përgjigje nga tre banka, prej tyre një me rëndësi sistemike, ndërsa në anën tjetër lehtësim për kërkesën mbi kolateral, përgjigje e dhënë nga dy banka, ku prej tyre njëra ka rëndësi sistemike. Këto pritje u ndikuan negativisht nga perspektiva jo e mirë në tregjet globale dhe vendore, si dhe pritjet për përkeqësim të cilësisë së portfolios kreditore. Përderisa, mbështetja nga FKGK dhe presioni i konkurrencës në mes të bankave ndikoi pozitivisht pritjet e bankave mbi kushtet dhe rregullat gjatë tremujorit të ardhshëm.

### Kërkesa për kredi


Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2022, kërkesa për kredi nga ana e ndërmarrjeve shënoi rritje, nivel dukshëm më i lartë krahasuar me TM3 2022. Sidoqoftë, kërkesa për kredi rezultoi të jetë më e ulët në krahasim me pritjet e bankave për TM4 2022 të shprehura në anketën e kaluar (TM3 2022) (grafiku 3). Kërkesa për kredi nga NVM-të kishte indeks pozitiv prej 0.22, përderisa kërkesa kreditore nga ndërmarrjet e mëdha gjeneroi indeks pozitiv marginal prej 0.06. Indeksi i gjeneruar për kërkesën për kredi nga NVM-të u ndikua nga përgjigjet e pesë bankave, prej tyre dy me peshë të madhe dhe rëndësi sistemike.

Sipas rezultateve të anketës, ndryshimet në kërkesën për kredi nga ndërmarrjet u ndikuan kryesisht nga kërkesa për financimin e inventarëve dhe kapitalit punues me indeks pozitiv prej 0.21, ndërsa kërkesa për financimin e investimeve fikse kishte një indeks të ulët prej 0.09. Rezultati i faktorëve

kontribuues në kërkesën për kredi u ndikua nga përgjigjet e pesë bankave, të cilat deklaruan rritje të kërkesës për financim të inventarëve dhe kapitalit punues dhe katër bankave që deklaruan rritje të kërkesës për financim të investimeve fikse. Cilësia e aplikacioneve të pranura nga ndërmarrjet nuk kishte ndonjë ndryshim të rëndësishëm gjatë TM4 2022.

Sipas anketës, gjatë TM4 2022 raporti i kredive jo-performuese të ndërmarrjeve u zvogëlua duke rezultuar me indeks negativ të ulët prej 0.09, gjithashtu ky rezultat është më i ulët krahasuar me rezultatin në anketën e kaluar ku përgjigjet e bankave gjeneruan indeks negativ prej 0.11 të këtij raporti. Ky rezultat u ndikua nga përgjigjet e pesë bankave, ku prej tyre tre banka (dy me rëndësi sistemike) deklaruan rënie të kredive jo-performuese përderisa dy banka tjera (një me rëndësi sistemike), deklaruan rritje të tyre.

Grafik 3. Ndryshimet në kërkesën për kredi nga ndërmarrjet dhe faktorët që kontribuan



Bankat nuk presin ndryshim të rëndësishëm të kërkesës për kredi nga ndërmarrjet gjatë tremujorit të ardhshëm. Këto pritje u ndikuan nga përgjigjet e pesë bankave, prej tyre dy banka presin rënie të kërkesës përderisa tre bankat tjera presin rritje deri në një masë të kërkesës për kredi. Rrjedhimisht, këto përgjigje neutralizuan njëra tjetrën dhe rezultuan në një indeks marginal. Kërkesa për kredi pritët të financojë investimet në kapital punues dhe inventarë. Njëkohësisht, bankat presin përkeqësim marginal të cilësisë së aplikacioneve të pranura për kredi, sidomos nga NVM-të.

Gjatë tremujorit të ardhshëm bankat presin që raporti i kredive jo-performuese ndaj gjithsej kredive për ndërmarrjet, të ndërroj kahje dhe të kaloj në indeks pozitiv të lartë prej 0.32, duke reflektuar pritjet e bankave për përkeqësim të cilësisë së portfolios kreditore. Këto pritje kryesisht u ndikuan nga dinamikat e rritjes së çmimeve në vend, e me të edhe rënia e fuqisë blerëse të klientëve. Gjashtë banka, ku katër prej tyre me rëndësi sistemike, deklaruan pritje për rritje të kredive jo-performuese të ndërmarrjeve.

## Kreditë ndaj ekonomive familjare


### Standardet kreditore

Standardet kreditore të aplikuara për ekonominë familjare gjatë tremujorit të katërt të vitit 2022 përgjithësisht kishin lëvizje marginale pozitive. Rezultati ishte i njëjtë për të dy llojet e kredive për ekonominë familjare, saktësisht indeks pozitiv 0.06. Rezultati reflekton përgjigjen e një banke me rëndësi sistemike e cila lehtësoj deri në një masë standardet kreditore për të dy llojet e kredive. Pritjet për tremujorin e katërt 2022, të deklaruara nga bankat në anketën e kaluar, rezultuan të përafërta me vlerat aktuale (grafiku 4). Faktor që rezultoi me kontribut pozitiv në standardet kreditore ishte ulja e rrezikut nga kolaterali i kërkuar me indeks pozitiv prej 0.06, faktor ky i deklaruar nga një

bankë e cila ka rëndësi sistemike në sektorin bankar, e që u mbështet kryesisht në marrëveshjet e bankës me kompanitë e ndërtimit.

Bankat deklaruan ndryshime marginale edhe në normën e aprovimit të kredive për ekonomitë familjare, saktësisht për kreditë për blerjen e shtëpive indeks pozitiv prej 0.07, ndërsa për kreditë konsumuese indeks pozitiv prej 0.05.

**Grafik 4. Ndryshimet në standardet kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare dhe faktorët që kontribuan**




Në tremujorin e parë 2023, bankat nuk presin lëvizje të rëndësishme në standardet kreditore për të dy llojet e kredive për ekonomitë familjare. Sidoqoftë, disa prej faktorëve gjeneruan indekse negative, që nënkuptojnë pritje për ndikim negativ në standardet kreditore, e të cilat janë perspektiva jo e mirë e tregut në vend në përgjithësi dhe atij bankar në veçanti, përkeqësimi i cilësisë së portfolios kreditore dhe perspektiva jo e mirë e bankave amë. Përderisa, pritjet për ndikim pozitiv në standardet kreditore bankat i mbështetën në qasjen e favorshme në financimin brenda vendit dhe në presionet nga konkurrenca. Bankat presin rënie marginale të nivelit të aprovimit të kredive për ekonomitë familjare. Konkretisht, pritet rënie e normave të aprovimit të kredive për blerjen e shtëpive me indeks negativ marginal prej 0.06.

### Kushtet dhe rregullat

Kushtet dhe rregullat për kreditë e reja për ekonomitë familjare përgjithësisht u shtrënguan deri në një masë. Rezultatet e gjeneruara kryesisht reflektojnë shtrëngime në nivel të njëjtë për të dy llojet e kredive. Saktësisht, bankat aplikuan norma më të larta të interesit (indeks negativ prej 0.21), përderisa lehtësuan margjinalisht kërkesën për kolateral (indeks pozitiv prej 0.06). Faktori kryesor në rritjen e normës së interesit ishte perspektiva jo e mirë e tregjeve globale, e që për pjesën më të madhe të bankave paraqet rritjen e normës së EURIBOR-it, normë e cila kryesisht aplikohet në kreditë me normë variable të interesit (grafiku 5).

Për tremujorin e parë të vitit 2023, bankat në përgjithësi presin shtrëngime marginale në kushtet dhe rregullat për kredi për ekonomitë familjare. Shtrëngimi i kushteve dhe rregullave pritet të jetë deri në një masë më i madh për kreditë konsumuese. Kryesisht, kushtet dhe rregullat për të dy kategoritë pritet të shtrëngohen përmes rritjes së normës së interesit, edhe pse në nivel më të ulët se sa vlerat për TM4 2022, ndërsa pritet të lehtësohen në nivel të ulët kërkesat për kolateral. Për më tepër, për kreditë konsumuese margjinalisht do të shtrëngohen edhe madhësia e maturiteti i kredive të aprovuara, përgjigje e deklaruar nga një bankë me rëndësi sistemike. Pas indeksimit të përgjigjeve të bankave rezulton që kryesisht perspektiva jo e mirë në tregun global e vendor të ndikojë pritjet e bankave për kushtet dhe rregullat gjatë tremujorit të ardhshëm.

Grafik 5. Ndryshimet në kushtet dhe rregullat e aplikuara për ekonomitë familjare




### Kërkesa për kredi

Pas gjenerimit të rezultateve për kërkesën kreditore në këtë tremujor, rezulton që kërkesa kreditore për ekonomitë familjare në përgjithësi ka shënuar rritje deri në një masë. Nëse e zërthejmë kërkesën kreditore sipas llojeve të kredive për ekonomitë familjare, rezulton që kërkesa për kredi konsumuese shënoi rritje me indeks pozitiv prej 0.22, ndërsa kërkesa për kredi për blerjen e shtëpive shënoi rritje me indeks pozitiv prej 0.18. Saktësisht, pesë banka, prej tyre tre me rëndësi sistemike raportuan për rritje të kërkesës për të dy llojet e kredive. Sidoqoftë, një bankë me rëndësi sistemike deklaroi rënie të kërkesës për kreditë për blerjen e shtëpive. Nëse krahasojmë rezultatet aktuale të kërkesës për kredi me pritjet e bankave të deklaruara në anketën e kaluar për të njëjtën periudhë, niveli aktual i rritjes së kërkesës është më i lartë për të dy llojet e kredive (grafiku 6).

Faktorët që ndikuan pozitivisht dinamikat në kërkesën për kredi ishin nevoja për financimin e shpenzimeve të konsumit (indeks pozitiv 0.17), dhe në një nivel të ulët pozitivisht ndikoi edhe perspektiva e tregut të patundshmërive (indeks pozitiv 0.10). Përderisa, rënia e konfidencës së klientëve për kapacitetin e ripagimit të kredive ndikoi negativisht kërkesën për kredi edhe pse në nivel të ulët (indeks negativ 0.10). Cilësia e aplikacioneve të pranuar nga ekonomitë familjare për kreditë për blerjen e shtëpive gjatë këtij tremujori rezulton të jetë kryesisht e pandryshuar për të dy llojet e kredive.

Sa i përket cilësisë së portfolios kreditore për ekonomitë familjare, bankat deklaruan përmirësim me indeks negativ 0.17, duke reflektuar përgjigjet e tre bankave për rënie të raportit të kredive jo-performuese dhe një banke e cila deklaroi rritje të këtij raporti.

Grafik 6. Ndryshimet në kërkesën për kredi nga ekonomitë familjare dhe faktorët që kontribuan



Në tremujorin e parë të vitit 2023, bankat në përgjithësi presin lëvizje negative marginale në kërkesën për kredi nga ekonomitë familjare. Konkretisht, bankat presin rënie marginale të kërkesës

për kredi për blerjen e shtëpive me indeks negativ prej 0.06. Pritjet për këtë dinamikë, u ndikuan nga përgjigjet e tre bankave (dy prej tyre me rëndësi sistemike) të cilat presin rënie të kërkesës për këto kredi, dhe tre bankave tjera (një me rëndësi sistemike) të cilat presin rritje të kërkesës për të njëjtat. Rezultatet e anketës sugjerojnë se bankat presin që rënia e konfidencës së klientëve për kapacitetin e ripagimit të kredive të ndikojë deri në një masë rënien e kërkesës për kredi gjatë tremujorit të ardhshëm. Përderisa, ndikimi i faktorëve që kontribuon pozitivisht kërkesën kreditore ishte marginal. Bankat deklaruan që presin përkeqësim, edhe pse në nivel të ulët, në cilësinë e aplikacioneve të pranuar për kredi, kryesisht nga kreditë për blerjen e shtëpive.

Gjatë TM1 2023, bankat presin që cilësia e portfolios kreditore e ekonomive familjare të përkeqësohet, bazuar në ndërrimin e kahjes së indeksit nga negativ në pozitiv krahasuar me tremujorin aktual. Saktësisht, pritjet e bankave për raportin e kredive jo-performuese rezultuan në indeks të lartë pozitiv 0.30, deklaruar nga pesë banka, ku katër nga to janë banka me peshë të lartë në kreditim dhe rëndësi sistemike.


## Financimi

Bankat raportuan rritje të theksuar të qasjes në financim gjatë tremujorit të katërt të vitit 2022. Rezultati i agreguar i përgjigjeve të bankave u ndikua nga përgjigjet e tetë bankave të cilat deklaruan rritje të financimit, ku prej tyre dy banka me rëndësi sistemike deklaruan rritje të konsiderueshme të qasjes në financim. Përderisa, vetëm një nga bankat, deklaroi rënie deri në një masë të financimit.

Bazuar në rezultatin e agreguar të përgjigjeve, gjatë këtij tremujori gjithsej financimi shënoi rritje më të lartë në krahasim me tremujorin e kaluar, saktësisht indeks pozitiv 0.60 (indeks pozitiv 0.47 në TM3 2022). Depozitat e ekonomive familjare gjeneruan një indeks pozitiv prej 0.60 (indeks pozitiv prej 0.40 në TM3 2022). Ky rezultat u ndikua nga përgjigjet e nëntë nga gjithsej dhjetë bankave pjesëmarrëse në anketë, ku dy prej tyre deklaruan rritje të konsiderueshme të depozitave nga ekonomitë familjare. Përderisa, financimi nga depozitat e ndërmarrjeve krahasuar me tremujorin paraprak ishte më i ulët, me indeks pozitiv 0.28 (indeks pozitiv prej 0.34 në TM3 2022), duke reflektuar përgjigjet e tetë bankave pjesëmarrëse, gjashtë banka deklaruan rritje (dy banka me rëndësi sistemike deklaruan rritje të konsiderueshme), ndërsa dy bankat tjera deklaruan rënie të financimit nga kjo kategori (një prej tyre bankë me rëndësi sistemike). Financimi nga bankat amë nuk kontribuoi në rritje të financimit, ngase nuk rezultoi të ketë ndonjë lëvizje të rëndësishme. Ndërsa, financimi nga institucionet ndërkombëtare financiare shënoi rënie marginale, e deklaruar nga vetëm një bankë me rëndësi sistemike me indeks negativ prej 0.07 (grafiku 7). Për dallim nga tremujori paraprak, në këtë tremujor dominoj financimi me maturim afatshkurtër. Konkretisht, depozitat afatshkurtra gjeneruan indeks pozitiv prej 0.38, ndërsa ato afatgjata gjeneruan indeks pozitiv prej 0.29.

Për tremujorin e ardhshëm, në përgjithësi bankat presin rritje të qasjes në financim në një nivel dukshëm më të ulët se sa ai i tremujorit aktual me indeks pozitiv prej 0.11. Financimi përmes depozitave të ekonomive familjare pritet të prijë rritjen e financimit të sektorit bankar me indeks pozitiv prej 0.24, pasuar nga financimi nga tregu i parasë me indeks pozitiv prej 0.12 (e deklaruar nga dy banka me rëndësi sistemike). Sa i përket maturitetit të financimit, bankat presin që rritjen e financimit ta dominojnë depozitat me maturitet afatgjatë me indeks pozitiv 0.19, ndërsa financimi me maturitet afatshkurtër pritet të rritet me indeks pozitiv të ulët prej 0.09 (grafiku 7).

Grafik 7. Ndryshimet në financimin e sektorit bankar



### Rezultatet e pyetjeve të fokusuara

Pyetësi i anketës për tremujorin e katërt të vitit 2022 është plotësuar me tre pyetje shtesë në përpjekje për të adresuar ndikimin e presioneve inflacioniste në sjelljen e klientëve, rrjedhimisht reflektimin dhe pritjet për materializimin e rrezikut kreditor. Në këto pyetje, bankat elaboruan mbi ndikimin indirekt të inflacionit në kostot e financimit të sektorit bankar. Gjithashtu, një nga pyetjet zbërthen ofertën dhe kërkesën kreditore sipas sektorëve ekonomik.

Çmimet në vend dhe globalisht janë në rritje qysh prej gjysmës së dytë të vitit 2021. Meqë rritja e çmimeve ndikon negativisht fuqinë blerëse të konsumatorëve, është me rëndësi të kuptohet sjellja e tyre për t’u përballur me këtë situatë, si dhe perceptimi i sektorit bankar mbi aftësinë ripaguese të klientëve, rrjedhimisht pritjet për materializimin e mundshëm të rrezikut kreditor.

Në këtë aspekt, sektori bankar ka vërejtur rritje të shpenzimeve të konsumit nga klientët e që u përkthye në rritje të kërkesës për kredi, e sidomos atyre konsumuese, për të mbuluar mungesat e mundshme afatshkurtra të likuiditetit. Klientët gjithashtu kanë kufizuar shpenzimet jo-esenciale për t’u përballur me efektet e rritjes së çmimeve. Sipas vlerësimit të bankave, segmentet më të prekura rezultojnë të jenë ekonomitë familjare, veçanërisht ato me të ardhura më të ulëta, si dhe ndërmarrjet mikro. Në kuadër të ndërmarrjeve, bankat vlerësojnë se të gjithë sektorët janë të prekur, mirëpo e veçojnë sektorin e ndërtimtarisë. Sidoqoftë, performancën e qëndrueshme financiare, e rrjedhimisht edhe kapacitetin ripagues të mirë, bankat i’a atribuojnë bartjes së kostos shtesë të çmimeve furnizuese/lëndës së parë tek konsumatori përfundimtar. Për më tepër, bankat qysh nga viti paraparak kanë aplikuar monitorim më vigjilent të performancës financiare të klientëve, e sidomos atyre në sektorët më të prekur, si dhe janë më konservativ gjatë vlerësimit të kapaciteteve të shlyerjes së borxhit, veçanërisht kundrejt ekonomive familjare.

Aspekt tjetër i mbuluar nga pyetjet shtesë ishte edhe ndikimi i rritjes së çmimeve në aftësinë e ripagimit të kredive nga klientët që nënkupton rritjen e rrezikut kreditor. Sentimenti i bankave nga përgjigjet e marra tregon se bankat presin që rreziku kreditor në rritje, të fillojë të materializohet qysh në tremujorin e parë të vitit 2023 dhe të përkeqësohet tutje në gjysmën e dytë të vitit. Sidoqoftë, bankat vlerësojnë si faktorë potencial zbutës në materializimin e rrezikut kreditor, nivelin e të hyrave shtesë nga remitancat që pritet të hyjnë në vend, sidomos gjatë TM3 2023.

Rritja e vazhdueshme e çmimeve në treg ndikon në zvogëlimin e të hyrave të disponueshme, gjë që reflektohet në kufizimin e mjeteve që mbahen në sektorin bankar. Rrjedhimisht, për të siguruar financimin nga depozitat bankat filluan dhe pritet të vazhdojnë me ofertë të favorshme për sigurimin e financimit, kryesisht përmes rritjes së normave të interesit në depozita, e cila përkthehet në rritje të kostos së financimit të bankave. Përveç kësaj, rritja e vazhdueshme e normave të interesit nga BQE, si dhe autoritetet tjera monetare, ndikoi koston e financimit, duke rritur kostot e financimit nga

bankat amë dhe institucionet financiare ndërkombëtare. Në këtë aspekt, pjesa më e madhe e bankave deklaruan rritje të kostove të financimit, duke sinjalizuar kështu pasiguri në performancën e tyre financiare, pasi kostot e rritura nuk mund të transmetohen në tërësi te klientët për shkak të presioneve të konkurrencës dhe ndjeshmërisë së klientëve ndaj normave të larta të interesit. Ndërsa, vetëm dy banka deklaruan se kostoja e financimit të tyre nuk ka ndryshuar.

Përgjigjet e disagreguara të bankave për ndërmarrjet, sipas sektorëve, tregojnë për kahjen e financimit të ekonomisë dhe dinamikat në sektorë të caktuar. Gjatë tremujorit të katërt 2022, standardet kreditore kryesisht mbetën të pandryshuara kundrejt tremujorit paraprak. Rezultat pozitiv marginal kishte vetëm për sektorin e tregtisë dhe atë të patundshmërive rezidenciale me indeks pozitiv 0.06, përgjigje e dhënë nga një bankë e vetme. Sektori i ndërtimtarisë, kishte ofertë të shtrënguar nga dy banka me peshë më të ulët në sektorin bankar, përgjigja e të cilave u neutralizua nga përgjigja për lehtësim të standardeve kreditore për këtë sektor nga një bankë me rëndësi sistemike. Përderisa, kushtet dhe rregullat u shtrënguan më masë më të madhe për disa sektorë, e veçanërisht për sektorin e patundshmërive me indeks negativ prej 0.17, dhe për sektorin e ndërtimtarisë me indeks negativ prej 0.12. Kërkesa për kredi shënoi rritje nga dy sektorë ekonomik. Sektori me kërkesën më të rritur për financim ishte ai i ndërtimtarisë me indeks pozitiv prej 0.17, rritje e deklaruar nga pesë banka. Përderisa, sektori i dytë me kërkesë të rritur ishte sektori i tregtisë me indeks pozitiv prej 0.13, rritje e deklaruar nga katër banka.

Bazuar në rezultatet e gjeneruara, gjatë TM1 2023 bankat pritjet të aplikojnë ofertë deri në një masë të shtrënguar për sektorin e ndërtimtarisë, ndërsa ofertë më të volitshme edhe pse në nivel marginal pritjet të ketë për sektorin e shërbimeve dhe prodhimit. Kushtet dhe rregullat pritjet të shtrëngohen në masë më të madhe për sektorin e ndërtimtarisë (indeks negativ 0.22), ndërsa për sektorët tjerë nuk pritjet ndonjë ndryshim i rëndësishëm i kushteve dhe rregullave. Në të njëjtën periudhë, kërkesa për kredi pritjet të ketë rënie nga sektori i ndërtimtarisë (indeks negativ 0.15) dhe rritje në nivel të ulët për sektorin e shërbimeve (indeks pozitiv 0.11).

## Pritjet për Inflacionin

Me qëllim të avancimit të kapaciteteve analitike dhe duke u bazuar në praktikatat më të mira rajonale dhe më gjerë, BQK ankton institucionet financiare në vend, duke u mbështetur në hipotezën se institucionet financiare bartin praktikatat më të mira nga bankat amë dhe kanë ekspertizën e duhur për të projektuar dinamikatat e inflacionit. Si rezultat, nga tremujori i tretë i vitit 2019, AKB është pasuruar edhe me pyetje shtesë, që adresojnë pritjet e bankave komerciale për zhvillimet në çmime në vend, duke ndihmuar kështu dhe plotësuar analizat tona në aspektin e analizimit, modelimit dhe parashikimit.

Në pyetësorin e fundit, përveç deklarimit të bankave lidhur me vlerësimet që kanë për nivelin e inflacionit në tremujorin aktual, pyetësori adreson edhe pritjet e bankave për tremujorin e dytë të vitit 2023 si dhe për vitin 2023 në përgjithësi. Anketa shërben gjithashtu edhe si një mjet për identifikimin e faktorëve specifik që potencialisht mund të ndikojnë pritjet e bankave për nivelin e caktuar të inflacionit.

## Metodologjia

Pritjet e inflacionit luajnë të paktën dy role të rëndësishme. Së pari, ofrojnë një statistikë përmbledhëse kuantifikuese për shkallën e inflacionit në të ardhmen, dhe së dyti, mund të përdoren për të vlerësuar besueshmërinë e objektivitetit të inflacionit të vendosur nga bankat qendrore.

Rëndësia e pritjeve të inflacionit është më e lartë për vendet të cilat e kanë adoptuar strategjinë e shënjestrimit të inflacionit. Për këto vende, pritjet e inflacionit, ndër të tjera, shërbejnë edhe si një



tregues i besueshmërisë së publikut ndaj bankës qendrore. Nëse besohet se banka qendrore do të reagojë për të arritur objektivin, atëherë edhe pritjet e agentëve ekonomik lidhur me shkallën e inflacionit do të ishin më pranë objektivit. Pritjet e inflacionit janë të rëndësishme edhe për bankat të cilat nuk posedojnë politikë monetare, duke qenë se shërbejnë si input i rëndësishëm në përcaktimin e çmimeve dhe pagave, si dhe në procesin e modelimit dhe parashikimit. Për më tepër, pritjet e inflacionit ndikojnë kërkesën agregate, që më pas ndikon ecurinë e inflacionit.

Për dallim nga inflacioni aktual i cili matet në mënyrë të drejtpërdrejtë, pritjet lidhur me inflacionin vlerësohen me metoda të tërthorta. Ndër më të përdorurat është anketimi i agentëve ekonomikë: konsumatorëve, bizneseve, bankave komerciale, etj. BQK, për herë të parë ka filluar me vlerësimin e pritjeve për inflacionin në tremujorin e tretë të vitit 2019, fillimisht me bankat komerciale.

Vlerësimet që merren nga bankat komerciale janë të formës sasiore të shoqëruara edhe me shpërndarje të probabilitetit. Pritjet për inflacionin vlerësohen për horizonte të ndryshme kohore, fillimisht vlerësimet për tremujorin aktual si dhe pritjet për tremujorin e ardhshëm dhe vitin aktual në përgjithësi. Mbledhja e informacionit përmes anketave pasohet nga procesi i sistemimit, përpunimit dhe agregimit për të gjetur mesataren e pritjeve të inflacionit nga bankat komerciale.

## Përmbledhja e rezultateve

Bazuar në anketën e realizuar në janar të vitit 2023, bankat kanë vlerësuar nivel më të ulët të inflacionit në tremujorin e parë të vitit 2023 krahasuar me tremujorin paraprak dhe presin një nivel edhe më të ulët të inflacionit në tremujorin e dytë të vitit 2023. Për vitin 2023, bankat presin që niveli i inflacionit do të jetë 6.4 përqind, nga 11.6 përqind sa ishte në vitin 2022.

Të dhënat e publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës për janar 2023 sugjerojnë se norma mesatare vjetore e inflacionit ishte rreth 12.1 përqind. Për tremujorin e parë dhe të dytë të vitit 2023, bankat presin se norma mesatare e inflacionit do të jetë 7.8 dhe 5.9 përqind. Shumica e bankave (7 sosh) presin që inflacioni në tremujorin e dytë do të jetë mbi 5 përqind ndërsa bankat tjera presin se inflacioni do të jetë nën këtë nivel.

Tabela 2. Pritja e inflacionit nga bankat, ndryshimi vjetor në përqindje

Bankat	TM1 2023	TM2 2023	2023
1	6.8%	6.6%	6.7%
2	11.5%	10.0%	9.5%
3	2.9%	2.9%	7.8%
4	5.5%	5.3%	4.7%
5	12.1%	5.0%	5.0%
6	10.0%	5.8%	5.8%
7	9.0%	7.0%	6.5%
8	8.6%	4.1%	5.7%
9	3.1%	2.7%	2.8%
10	9.1%	9.3%	9.3%
<b>Mesatarja</b>	<b>7.8%</b>	<b>5.9%</b>	<b>6.4%</b>

Burimi: Bankat komerciale dhe kalkulimet e BQK-së.


Siç ilustron figura 8, shpërndarjet e raportuara të probabilitetit tregojnë për një siguri relativisht të lartë në lidhje me rezultatin e ardhshëm të inflacionit, pasi shpërndarja e probabilitetit të bankave është e përqendruar në inflacionin e pritur.

Në komentet e tyre cilësore, bankat kanë përmendur faktorët e mundshëm, të brendshëm dhe të jashtëm, që kanë ndikuar në shkallën e inflacionit:

- ✓ Lufta në Ukrainë është arsyeja kryesore e rritjes së çmimeve për shkak se Rusia dhe Ukraina janë furnizues të rëndësishëm të lëndëve të para, mirëpo pritet që këto çmime të stabilizohen paksa dhe të mos ketë ngritje enorme sikurse vitin e kaluar;
- ✓ Si faktor që mund të ketë ndikuar në ngadalësimin e rritjes së çmimeve, bankat kanë përmendur rritjen e normave të interesit nga Rezerva Federale në SHBA e cila më pastaj është pasuar nga bankat tjera si Banka Qendrore Evropiane, Banka e Anglisë, etj.;
- ✓ Zhvillimet e çmimeve në tregjet ndërkombëtare si dhe varësia e madhe e ekonomisë së vendit nga importet si rezultat i kapaciteteve të ulëta prodhuese vlerësohet të jenë determinues kryesor të inflacionit në vend.

Duke pasur parasysh dinamikat me të cilat po karakterizohen çmimet në vend, mendojmë se pritjet e bankave janë realiste.

**Grafik 8. Probabiliteti i inflacionit për TM2 2023 (boshti-x: pritjet e inflacionit, ndryshimi vjetor në përqindje; boshti-y: probabiliteti)**



Burimi: Bankat komercial dhe kalkulimet e BQK-së.



Rr. Garibaldi, nr.33, 10000 Prishtinë,  
Republika e Kosovës  
Tel: +383 38 222 055; Fax: +383 38 243 763  
Web: [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)